

	Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi	PR-MO-004
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 1 from 11</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

## Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi

	Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi	PR-MO-004
	ver. 1.0	page 2 from 11
Departamenti: Operimi i Tregut		Sektori:

## PËRMBAJTJA

1.QËLLIMI.....	3
2.FUSHA .....	3
3.PALËT PËRGJEGJËSE DHE PËRDORUESIT.....	4
4.PËRMBLEDHJE.....	5
5. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS – MBLEDHJA E TË DHËNAVE TË MATJES.....	6
5.1. Dispozitat e përgjithshme.....	6
5.2. Mbledhja e Vëllimeve të Matura.....	7
5.3. Baza e të Dhënave të Matjes.....	8
5.4. Deklarimi i Vëllimeve të Matura dhe Kontestet .....	9
6. DOKUMENTET/FORMULARËT .....	11

	<b>Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi</b>	<b>PR-MO-003</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 3 from 11</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

## 1. QËLLIMI

Kjo procedurë Operative ofron informata se si duhet të organizohet dhe menaxhohet mbledhja e të Dhënave të Njehsorëve në mënyrë që t'i mundësoj KOSTT t'i përmbush detyrat e veta për faturimin e kostove të veta për të përmbushur detyrat e veta për faturimin e palëve të treta si definohet në Licencën për Operatorin e Tregut (OT) të nxjerr nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Tetor 2006.


Termet specifike të përdorura në këtë procedurë janë të definuara në një dokument të veçantë "Fjalorthi i Procedurave Operative" i cili do të dorëzohet dhe publikohet së bashku me Procedurat. Termet të cilat tashmë janë të definuara në Rregullat e Tregut, Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Matjes nuk do të definohen në Fjalorthin e Procedurave Operative.

## 2. FUSHA

Kjo Procedurë Operative ofron udhëzime për mbledhjen e të dhënave të matjes dhe arkivimin, të cilat janë të nevojshme për të kryer procesin përkatës të faturimit.

Kjo përfshinë leximin e njehsorëve, mbledhjen e të dhënave të njehsorëve dhe ruajtjen e të dhënave të njehsorëve në Bazën e të Dhënave të Njehsorëve. Përfshinë gjithashtu edhe përjashtimet të cilat janë të nevojshme për shkak të variablave teknike të kushteve aktuale të rrjetit të transmisionit dhe shpërndarjes në Kosovë.

Kjo procedurë nuk përfshinë mbledhjen e të dhënave të matjes në nivel të Rrjetit të Shpërndarjes.

	Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 4 from 11
Departamenti: Operimi i Tregut		Spektori: Barazimi Përfundimtar

### 3. PALËT PËR GJEGJËSE DHE PËRDORUESIT

#### Operatori i Tregut

- Nxjerrë, zbaton, azhurnon dhe modifikon këtë procedurë, varësisht nga modifikimi i legjislacionit primar dhe sekondar në Kosovë.
- Vë këtë procedurë operative në dispozicion për operatorët e matjes në Rrjetin e Transmisionit dhe Shpërndarjes, të cilët kërkohet që sipas Rregullave të Tregut (RrT) të dorëzojnë të dhënat e matjes.

#### Operatori i Sistemit

- Themelon dhe mirëmban Bazën e të Dhënave të Matjes
- Pranon të Dhënat e Matjes nga operatorët e rrjetit në Rrjetin e Shpërndarjes dhe Transmisionit.
- Validon dhe futë të Dhënat e Matjes në Bazën e të Dhënave të Matjes
- Ofron të Dhënat e Matjes të miratura, agreguara ose zëvendësuara (nëse nevojitet) OT për qëllime të Barazimit dhe Faturimit.

#### OST dhe OSSh (KEK Shpërndarja); KEK Gjenerimi / NP Ibër Lepenc/ Gjeneratorët tjerë

- Regjistrojnë pajisjet e tyre të matjes sipas Procedurës Operative ET002
- Përcjellë të Dhënat e Matjes në formatin, frekuencën dhe kualitetin si definohet në RrT, Kodin e Matjes dhe në këtë procedurë operative
- Ofron të Dhënat e Matjes nga gjenerimi të lidhur në Rrjetin e Shpërndarjes (dmth. hidrocentrali Lumbardhi




#### 4. PËRMBLEDHJE

Kjo procedurë ofron rregullat për mbledhjen e të dhënave të matura nga Pjesëmarrësit e Tregut në mënyrë që t'i mundësoj OT të përmbush detyrat e veta lidhur me faturimin sipas qëllimeve të veta dhe duke vepruar si agjent faturues si definohet në verzionin aktual të licencës së OT dhe RrT.

Në tabelë janë paraqitur hapat kryesor, plani kohor dhe përgjegjësit:


Veprimet/Dokumentet	Pala Tregtare D - Dërgon P- Pranon	OT D - Dërgon P- Pranon	OS D - Dërgon P- Pranon	Plani kohor Në ditë pune pas fundit të Muajit Barazues
Mbledh, agregoj dhe zëvendsoj leximet mujore të njehsorëve			<b>P</b>	1-4
Transferoj të Dhënat e Matjes të miratuara		<b>P</b>	<b>D</b>	-4
Deklarimi i vëllimeve të matura	<b>P</b>	<b>D</b>		5
Pyetjet rreth vëllimeve të matura	<b>D</b>	<b>P</b>		6-9
Të dhënat e matura të pajtuara për faturim - Pro-Forma fatura	<b>P</b>	<b>D</b>		10

	Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi	PR-MO-003
	ver. 1.0	page 6 from 11
Departamenti: Operimi i Tregut		Sektori: Barazimi Përfundimtar

## 5. PËRMBLEDHJA E PROCEDURËS – MBLEDHJA E TË DHËNAVE TË MATJES

### 5.1. Dispozitat e përgjithshme

- 5.1.1. I tërë gjenerimi i energjisë dhe konsumi i energjisë për të gjithë Pjesëmarrësit e Tregut duhet të matet në mënyrë elektronike në intervale prej 1 ore duke përdorur pajisjet matëse përkatëse. Kjo ndikon të gjitha pikat e lidhjes së rrjetit ku Sistemi Matës ARES është i instaluar si dhe të gjitha nyjet e rrjetit dhe pikat e lidhjes së përdoruesve të sistemit, ku pajisjet moderne të matjes janë instaluar.
- 5.1.2. Sipas kushteve të 5.1.1, të gjitha pajisjet matëse duhet së paku të përmbushin kërkesat minimale të definuara në Kodin e Matjes.
- 5.1.3. Vëllimet e matura duhet të lexohen nga distanca kurdoherë që është e mundur.
- 5.1.4. Për shkak të variablave teknike aktuale, disa lloj të derogimeve lidhur me leximet e njehsorëve duhet të merren parasysh. Prandaj, Procedura Operative T002 duhet të konsiderohet.
- 5.1.5. Vëllimet e Matura të Gjenerimit të ndërlidhura duhet të lexohen nga OSSh dhe duhet të ofrohen nga OSSh për KOSTT (OT dhe OS).
- 5.1.6. Të dhënat për sasinë e energjisë së matur duhet të ruhen në hapësirën (depon) për ruajtje të pajisjeve matëse të secilit Pjesëmarrës së Tregut dhe duhet t'i ofrohet KOSTT në formatin e definuar nga KOSTT (OT & OS).
- 5.1.7. Për Sistemet Matëse ku është pajtuar se komunikimi automatik nuk ofrohet, KOSTT do të – sipas orarit për leximin e të dhënave të njehsorëve të publikuar në faqen elektronike OT – mbledh të dhënat për energjinë e matur në baza mujore. Kjo do të bëhet me kompjuter mobil.
- 5.1.8. Ku njehsorët nuk janë të instaluar në kufirin komercial të definuar nga KOSTT, barazimet e njehsorëve për gjeneratorët / transformatorët e njëjësive gjeneruese do të bazohen në kushtet normale të ngarkesës së plotë dhe kalkulimin e humbjeve për transformatorë e centralit në 75% të kapacitetit të instaluar të mbështjellës së tensionit të ulët. Kjo do të kalkulohet dhe aplikohet në njehsorin përkatës në mënyrë që të lejohet Pjesëmarrësi i


	<b>Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi</b>	<b>PR-MO-003</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 7 from 11</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

Tregut përgjegjës për pikën matëse për të parë të dhënat e barazimit në ekranet e njehsorëve kurdoherë që është e mundur.

- 5.1.9.** Ku nuk është teknikisht e realizueshme, kalkulimi i barazimeve të njehsorëve duhet të bëhet nga KOSTT në bazën e të dhënave të matjes. Të gjitha parametrat e përdorur në kalkulimin e barazimeve të njehsorëve duhet të ruhen individualisht dhe ndaras në bazën e të dhënave për matje dhe duhet të shtypen në deklaratë ashtu që kalkulimet të mund të auditohen.

## 5.2. Mbledhja e Vëllimeve të Matura


- 5.2.1.** Sipas RrT, të gjitha të Dhënat e Matura duhet të mblidhen brenda 4 Ditëve të Punës pas fundit të periudhës Barazuese (muajit).
- 5.2.2.** Ku ekziston komunikimi në pikën matëse, njehsorët duhet të lexohen nga distanca nga OST/OSSh në baza të rregullta në pajtim me Kodin e Matjes. Leximet duhet të kryhen në të njëjtën ditë secilin muaj kur është e mundur për përputhshmërinë si kërkohet me Kodin e Matjes.
- 5.2.3.** Ku nuk ekziston komunikimi të dhënat e njehsorëve do të mblidhen nga personeli i autorizuar i Operatorit të Sistemit (OS) të KOSTT gjatë 5 ditë të para të punës pas fundit të periudhës përkatëse të barazimit (muaj).
- 5.2.4.** Në rast të vizitave jo të rregullta OS do të njoftoj secilën Palë Tregtare dy ditë pune para vizitës në teren për planin kohor të mbledhjes së të Dhënave të Njehsorëve. Sidoqoftë, zyrtarët përgjegjës të OS dhe OSSh kanë të drejtë të vizitojnë, lexojnë dhe inspektojnë matjet në çfarëdo kohe gjatë muajit pa njoftim paraprak ose miratim të ndonjë pale. Qasja në lokacionin e matjes duhet të jetë e menjëhershme dhe nuk duhet të refuzohet për çfarëdo arsye.
- 5.2.5.** Të dhënat për energjinë e matur duhet të lexohen nga OST në nivel të transmisionit ose nga OSSh në prani të një punëtori të shpallur të Pjesëmarrësit të Tregut, në objektet e të cilit është instaluar Sistemi Matës.
- 5.2.6.** Të gjitha të dhënat e njehsorëve duhet të ruhen në pajisjet e duhura si definohet nga OS.
- 5.2.7.** Të gjitha të dhënat e njehsorëve duhet të dorëzohen në formatin e definuar nga OS. Formatin dhe metoda e prezantimit duhet të bëhen të qarta për pjesëmarrësin e tregut.

	<b>Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi</b>	<b>PR-MO-003</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 8 from 11</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

### 5.3. Baza e të Dhënave të Matjes


- 5.3.1.** OS do të themeloj dhe mirëmbaj një bazë të të dhënave për
- (a) të dhënat e pozicionuara të pajisjeve matëse si ofrohen nga Pjesëmarrësit e Tregut gjatë regjistrimit të sistemeve matëse.
  - (b) Ruajtja e të Dhënave të Matjes të dorëzuara nga OST ose OSSh
- 5.3.2.** Për më tepër OT do të zhvilloj rregullat për agregimin e leximeve të Njehsorëve në mënyrë që të përmbush kërkesat e procesit të faturimit.
- 5.3.3.** Secili Pjesëmarrës i Tregut ka të drejtë të kërkoj të dhënat e matjes për ato pajisje matëse të cilat janë të instaluar në pajisjet teknike ku ai ka përgjegjësinë ose për të cilat ai ka interes komercial, si një palë në transaksion.
- 5.3.4.** Në rast të dyshimeve ose Kontesteve mbi Njoftimet e Leximit të Njehsorëve sipas 5.4, të dhënat e pozitës dhe leximet e njehsorëve mund të kërkohen nga OS.
- 5.3.5.** Prandaj, OS jep ekstrakte nga baza e të dhënave në formë të raporteve të standardizuara të cilat duhet të prodhohen me kërkesën e Pjesëmarrësit të Tregut brenda dy (2) Ditë Pune.
- 5.3.6.** OS do të ofroj OT të gjitha të dhënat e njehsorëve të kërkuara deri me dhe jo më vonë se 4 Ditë Pune pas fundit të Periudhës Barazuese përkatëse.




	<b>Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi</b>	<b>PR-MO-003</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 9 from 11</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

#### 5.4. Deklarimi i Vëllimeve të Matura dhe Kontestet

- 5.4.1.** KOSTT në kapacitetin e vetë si OT duhet – sipas dispozitave të RrT Neni 66 – të dërgoj një Deklaratë të Vëllimeve të Matura për Pjesëmarrësit e Tregut për të gjitha Sistemet Matëse, të cilat janë të regjistruara për Palën Tregtare. Kjo Deklaratë e Vëllimeve të Matura duhet të dërgohet brenda 5 Ditëve të Punës pas fundit të periudhës barazuese (muaj).
- 5.4.2.** KOSTT në kapacitetin e vetë si OT duhet – sipas dispozitave të RrT Neni 66 – dërgoj një Pro-Forma Faturë për Pjesëmarrësit e Tregut për të gjitha Sistemet Matëse të cilat janë të regjistruara për Palën Tregtare në 10 Ditët e Punës pas fundit të muajit Barazues.
- 5.4.3.** OT në kapacitetin e vet si Sektor i Barazimit duhet që pas lëshimit të Pro-Forma faturave për Pjesëmarrësit e Tregut të mbaj kopjet elektronike të të gjitha Pro-Forma faturave të cilat janë dërguar.
- 5.4.4.** Të gjithë Pjesëmarrësit e Tregut duhet që pa vonesë të kontrollojnë Deklaratën e Vëllimeve të Matura.
- 5.4.5.** Pjesëmarrësit e Tregut kanë të drejtë të kërkojnë raporte detale nga Baza e të Dhënave të Sistemeve të Matjes jo më vonë se (9) Ditë Pune pas fundit të Periudhës Barazuese (muaj).
- 5.4.6.** Në rast të kontestit për të Dhënat e Matura, Pjesëmarrësi i Tregut duhet t'i dërgoj OT me shkrim përmes postës, faksit ose e-mail një Kërkesë për Kontestin e të Dhënave të Matura deri në ditën e (9) të Punës pas fundit të muajit Barazues.
- 5.4.7.** Kërkesa për Kontestin e Vëllimeve të Matura duhet që së paku të përmbaj:
- (a) Periudhën kohore të kontestuar
  - (b) Sistemet Matëse të Kontestuara
- 5.4.8.** OT duhet që aq sa është arsyeshëm e mundur të mbështet Pjesëmarrësin e Tregut në pastrimin e Vëllimeve të Matura të kontestuara.
- 5.4.9.** Kur pastrimi dëshmon se duhet të përdoren vëllimet e matura ose të zëvendësuara të ndryshme, KOSTT në kapacitetin e vet si OS duhet të bëjë çfarëdo përpjekje të azhurnoj Bazën e të Dhënave të Matjeve, dhe të nxjerr një Deklaratë të re të Vëllimeve të Matura.
- 5.4.10.** Në rast se kontesti nuk mund të zgjidhet, KOSTT në kapacitetin e vet si OS duhet të përgatis pro-forma Faturën dhe Faturën në pajtim me RrT

	<b>Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi</b>	<b>PR-MO-003</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 10 from 11</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

Neni 66 dhe pala tregtare do të kontestoj Faturën në pajtim me Nenin 69 (Reklamimi i Faturave) sipas dispozitave të Procedurës Operative T701.

	Mbledhja e të dhënave të njehsorëve dhe agregimi	PR-MO-003
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 11 from 11</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		<i>Sektori: Barazimi Përfundimtar</i>

## 6. DOKUMENTET/FORMULARËT

### Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1	Rregullat e Tregut
2	Kodi i Matjeve

### Shënimet për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.0	Janar 2008	Verzioni inicial	5 vite